

## E DIELA E ULOKUT

## THIRRTORET, T. III

*Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit, edhe dy të Ulokut, dyke përsëritur të parën, në Tingëllin I:*

O Krisht mëshirëplot, që gatove njerinë me dorën tënde, ardhe në botë për të shëruar të sëmurët. E ngrite Ulokum në Liqen të Dhënve, e shërove Gjakrjedhurën, e mëshirove Kananeanën, e dëgjove lutjen e Kryeqindësit. Përandaj pra të thërresim: O Zot i gjithëfuqishim lavdi më ty. **(dy herë)**

Uloku i vdekur i pavarrosur, kur të pa të thirri o Zot: Kij mëshirë për mua, shtrati m' u-bë varr, se ti je burimi i shërimeve; o Zot i gjithëfuqishim lavdi me ty.

LAVDI, T. T. I. U-ngjit Jesuj në Jerusalem, në Liqenin e Dhënve, ku gjeti një Ulok, të dergjur prej vjetesh, edhe si mjek i shpirteve dhe i trupeve i tha: Ngrer-e shtratin dhe barit, dhe leçit fuqinë time, dhe përdëllimin e math.

TANI, T. III. Sa po çuditemi, për lindjen tënde me nam . . . **(shiko Kremtoren, f. 87)**

## PASVARJET, T. III

Me pësimin tënt o Krisht, erre dritën e diellit, dhe kur u-ngjalle prej së vdekurësh, përhape gëzim kudo, prit-i pra mirësisht, hymnet që blatojmë plot me bes' e mall.

*Pastaj këndohen Vargëzimet e Pashkës, Lavdia e Pashkës, dhe Përlëshoret e Tingëllit III. Në Shërbesën e Mëngjesit, Ndënjësoret, Dëgjimi, dhe Shkallesat e Tingëllit III. Pastaj:*

## SHKURTORJA, T. III

## PAS I PARTHENOS SIMERON

Shpirtin tim o Zoti Krisht, që u-sëmur nga mëkatat, edhe dergjet si ulok, anës liqenit i shtrirë, ngrer-e ti, me forcën tënde të perëndishme, si një mjek, që i shëron të sëmurët, të thërres me mall dhe besë: O Zot i dhëmpshur, nder dhe lavdi më ty.

## SHTEPIA

O Jesu Perëndi, që e mban në dorë tërë botën, i bashkëpanismë me Atin, dhe bashkëzotëronjës i gjithësisë me Shpirtin Shenjt, u-çfaqë si njeri, dhe shërove të sëmurët, edhe ndriçove të verbërit, edhe ngrite ulokët. Përandaj pra të thërresim: O Zot i dhëmpshur, nder dhe lavdi më ty.

## SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Katërtë pas Pashkës së Ma-

dhe, kujtojmë çudinë e Ulokut, që bëri Krishti në Liqenin e Silloamit.

Me dhëmpshërinë tënde të pamatur, o Krisht, o Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

*Zbritësoret e Pashkës, Ungjilli Mëngjedor V (shiko Kremtoren, f. 144-6), dhe Madhështimet e Pashkës, pastaj:*

## DERGIMESORET, T. II

### SARKI IPNOSAS

Si fjete si njeri me trup, o Mbreti yne Zoti Krisht, u-ngjalle të tretën ditë, dhe ngrite gjyshin Shën Adam, dhe e dërmovë vdekjen krejt. Pashkë burim i jetës, shpëtim i besnikëve.

## PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Qëndroj Jesuj në një liqen, të quajtur të Dhënve, e pa Ulokun mi një shtrat, pa nonjë shpresë fare, dhe vajti dhe e pyeti, a e deshte shëndetin, e dua tha ay me gas, pra Jesuj menjëherë e urdhëroj, ta ngrente shtratin edhe të shkonte, dhe të mos mëkatonte më, dhe ta shpëtonte shpirtin.

## LAVDERIMET, T. III

*Këndohen tetë, domethënë katër të Tingëllit III, katër të Pashkës së Madhe, pastaj:*

LAVDI, T. T. IV. Ulokun nuk e shëroj liqeni, po fjala jote o Zot, se zëri yt i mprehtë, ia preu vargonjtë, dhe ia çliroj trupin, pas mëshirës sate, lavdi më ty.

TANI, T. T. I. Ardhi dit' e Ngjalljes . . .

*Doksollogjia e Madhe, dhe Mesha e Shën Joan Gojartit. Në Hyrjen Përlëshorja e Pashkës, e Tingëllit, Hyrtorja dhe Shkurtorja e Pashkës, Hymni Trishenjtor, dhe pastaj:*

## APOSTULLI

Këndojeni Perëndinë tonë, këndojeni.

Te gjithë kombet, trokisni duartë.

Kendimi prej Akteve të Apostujve.

Më ato ditë, tek po shkonte Pjetri nëpër gjithë ato vise, zbriti edhe në Shenjtorët, që banonin në Lyddë. Edhe atje gjeti një njeri, të quajtur Enea, i cili ishte ulok, edhe dergjej në shtrat që prej tetë vjetesh. Edhe Pjetri i tha: "Enea, Jesu Krishti të shëron. Ngrehu dhe shtroje shtratin." Edhe ay u-ngrit menjëherë.

Edhe në Joppë ishte një dishepuleshë, e quajtur Tabitha, e cila e kthyer domethënë Kaprollë. Kjo grua kishte bërë shumë vepra të mira dhe elmosha. Edhe rastisi që ato ditë u-sëmur, edhe vdiq; edhe passi e lanë e vëndosnë në një dhomë të sipërme. Edhe meqënëqë Lydda ishte afër Joppës, edhe dishepujtë dëgjuan që Pjetri ndodhej atje, dërguan dy njerës, edhe iu-lutnë të shkonte gjer tek ata pa vonesë. Edhe Pjetri u-ngrit edhe vajti me ata; edhe kur arriu, e shpunë në dhomën e sipërme; edhe te gjitha të vejat iu-afruan, dyke qarë dhe dyke treguar robat edhe këmishët, të cilat u kishte bërë Kaprolla, kur ishte e gjallë. Po Pjetri i nxori të gjitha jashtë, dhe ra më gjunjë, dhe u-fal. Pastaj u-kthye nga kufoma, dhe i tha: "Tabitha, ngrehu." Edhe ajo i çeli sytë, dhe kur e pa Pjetrin, u-ngrit, edhe ndënji. Edhe Pjetri i dha dorën, edhe e ngriti; edhe i thirri Shenjtorët edhe të vejat, edhe ua tregoj të gjallë. Edhe

kjo u-bë e njohur në tërë Joppën, edhe shumë e besuan Zotin.

### UNGJILLI PAS JOANIT

Më atë kohë, Jesuj u-ngjit në Jerusalem. Dhe ishte në Jerusalem një liqen pranë Tregut të Dhënve, që quhej Hebraisht Bethesda, dhe që kishte pesë kamare. Nër ato ishin shtrirë një shumicë e madhe prej të sëmurësh, të verbërësh, të çalësh, të fishkurësh, që prisnin lëvizjen e ujit. Se një Engjëll zbriste më një kohë në liqen, dhe e trubullonte ujën; dhe i pari, që hynte pas trubullimit të ujit, shërohej nga çdo sëmundje që kishtë. Edhe ishte atje një njeri i sëmurë që prej tridhjetë e tetë vjetësh. Edhe Jesuj, kur e pa të shtrirë, edhe mori vesh që vuante kështu prej shumë kohe, e pyeti: “A do të shërohesh?” Edhe i sëmuri iu-përgjeh: “O Zot, nuk kam njeri, i cili të më hedhë në liqen, kur trubullohet uja, edhe gjer sa të vete unë, një tjetër zbret përpara meje.” Edhe Jesuj i tha: “Ngrehu, merr-e shtratin mi supet, edhe barit.” Edhe menjëherë i sëmuri u-shërua, edhe e ngriti shtratin edhe bariti. Edhe ishte e Shtunë atë ditë. Judenjtë, pra, i thoshnin të shëruarit: “Sot është e Shtunë; është kundër ligjës ta ngresh shtratin.” Edhe ay u-përgjeh: “Ay, që më shëroj, ay më tha, ‘Merr-e shtratin mi supet, edhe barit.’” Ahere ata e pyetnë: “Cili është ay njeri, që të tha, ‘Merr-e shtratin mi supet edhe barit.’” Po i shëruari nuk e dinte cili ishte, se Jesuj kishte shkuar jashtë midis gjiindjes, që ndodhej atje. Pastaj Jesuj e gjeti një herë tjetër në Shenjtërorën, edhe i tha: “Shiko, tani që u-shërove, mos mëkato më, që të mos të ngjanjë nonjë më e këqë.” Edhe njeriu shkoj, edhe i lajmëroj Judenjtë që Jesuj ishte ay, që e kishte shëruar.

*Pastaj Mesha vazhdon dhe mbaron si të Dielën e Myrrë-prurseve.*